

## FJALOR DIALEKTOR ME VLERË TË SHUMËFISHTË

*Mehmet Halimi*

Instituti Albanologjik  
i Prishtinës

KUD 809.198.3—3  
Vështrim

Marrë për botim më 21 shtator 1987

Përmbajtje e shkurtër: Në këtë vështrim merret në shqyrtim *Fjalori dialektor i të folmes së Arbëneshëve të Zarës*, hartuar nga Dr. Kruno Kërstiqi, i cili ngërthen material të pasur leksikor nga kjo oazë dialektore, duke paraqitur tiparet specifike të këtij ishulli gjuhësor. Si i këtillë ky fjalor dialektor shquhet për një vlerë të shumëfishtë shkencore në përgjithësi, por njëkohësisht është edhe një kontribut i mirë për leksikografinë shqiptare në veçanti.

Fjalori i të folmes së arbëneshëve të Zarës hartuar nga Dr. Kruno Kërstiqi i titulluar: „*Rječnik govora zadarskih arbanasa*”, Zadar — Mjesna zajednica Arbanasi 1987, 134 faqe, dëshmon për vitalitetin e një të folmeje të izoluar dhe të shkëputur nga trualli i saj i lashtë që nga mesjeta e vonë, por e cila në ligjërimin e saj prej dy shekujsh e gjysmë, megjithë ndikimet e fuqishme të gjuhëve në kontakt në truallin e ri, ende ruan një thesar relativisht të pasur leksikor dhe sistemin e saj fonetik, morfologjik, sintaksor e leksikor të një të folmeje autoktone e origjinale shqipe.

Ky është një fjalor dialektor me rëndësi të shumëfishtë shkencore sepse pasqyron këtë të folme jo vetëm nga aspekti dialektor, por edhe nga aspekti *leksikor, onomastik, folklorik, etnografik e historik*. Si i këtillë ky fjalor, me të dhënat që sjellë në përgjithësi dhe me materialin gjuhësor në veçanti, e pasuron leksikografinë shqiptare edhe me një fjalor të denjë e të thukët dialektor. Ky fjalor shquhet edhe me thënie e shprehje dialektore, duke u radhitur kështu në traditën e fjalorëve dialektor që nga *Fjalori i Frang Bardhit* (1635), që konsiderohet ndër fjalorët më të hershëm të shqipes, pastaj *Fjalori i Kristoforidhit* (1904), *Fjalori i Bashkimit* (1908), *Fjalori i Ri i Gazullit* (1940), *Fjalorth i Ri i Pano Tases* (1941), *Fjalor i Arbëreshëve t'Italisë i Emanuele Giordano* (1964), *Fjalorth i fjalëve të rralla i A. Zyberit* (1979), *Fjalor fjalësh e shprehjejs popullore*, i hartuar nga një grup auto-

rësh të Institutit Albanologjik\* (1982), i cili ngërthen në vete 5206 fjalë të vjela në 358 pika shqipfolëse të trevave të ndryshme të RSF të Jugosllavisë. Risi te ky fjalor është se ka edhe hartën e trevave dhe pikave shqipfolëse, duke pasqyruar kështu një shtrirje gjeografike të territorit burimor prej nga janë shënuar fjalët në fizionominë e tyre dialektore me tipare fonetike e morfologjike të çdo të folmeje veç e veç. Pas fjalorit të Kristoforidhit *Fjalori fjalësh e shprehjesh popullore* përfaqëson një regjion më të gjerë fjalëmbledhësi gjeografik ndër të gjithë fjalorët të tjerë dialektorë.

Prandaj mund të themi se në historinë e traditës së fjalorëve dialektorë bën pjesë edhe *Fjalori i të folmes së arbëneshëve të Zarës* (Rječnik govora zadarskih Arbanasa) i dr. Kruno Kërstiqit për të cilin e kemi fjalën këtu në vështrim tonin, është një fjalor dialektor dygjuhësor (shqip-kroatisht), në të cilin materiali bazë i shqipes së arbëneshëve të Zarës paraqitet me shpjegime në gjuhën serbokroate. Kur kemi parasysh se ky fjalor u hartua nga një pjesëtar i kësaj të folmeje dialektore, ai fiton peshë edhe më të madhe në origjinalitetin e tij, sepse sjell material autentik nga e folmja e kësaj oaze dialektore. Prandaj, mbështetur në këtë të dhënë lidhur me këtë të folme, ky fjalor ka një lëndë të pasur që mund të shërbejë për studime të mëtejme dialektologjike. Madje mund të thuhet se ky fjalor mund të konsiderohet si një bazë e fortë për të korrigjuar një numër studimesh dialektologjike të mëhershme nga njëra anë, por edhe për të plotësuar e për të pasuruar edhe studimet e monografitë e shquara shkencore nga ana tjetër.

*E folmja e arbëneshëve të Zarës* si e folme e izoluar, e shkëputur nga trualli saj i lashtë, ka ruajtur një numër të konsideruar fjalësh arkaike, të cilat sot nuk i ndeshim në të folmet e tjera në trojet autoktone midis të cilave ka vazhdimësi tokësore gjeografikisht të pandërprerë. Prandaj, vështruar nga ky kënd ndonjëra nga këto fjalë arkaike të kësaj të folmeje, dikur periferike, tani e izoluar, mund të riaktivizohet edhe në ditët tona, duke u bërë kështu pronë e leksikut të gjithmbarshëm të shqipes letrare kombëtare.

Sot për sot nuk mund të spikaten me një frymë dhe me një vështrim të gjitha vlerat shkencore albanologjike të këtij *fjalori dialektor* të kësaj oaze gjuhësore. Rëndësinë e tij të shumëfishtë shkencore do ta dëshmojë e ardhmja. Kemi bindjen se ky fjalor në të ardhmen do të shërbejë si lëndë hulumtimi e studimi të gjithanshëm nga shumë lëmenj të shkencës albanologjike, e ve-

\* Ky fjalor u hartua nga: Sulejman Drini, Ibrahim Goçi, Mehmet Halimi dhe Skënder Gashi, duke u mbështetur në kartotekën e Degës së Gjuhësisë së Inst. Albanologjik të Prishtinës dhe duke marrë në shqyrtim 20.000 skeda fjalësh të mbledhura në ekspedita kërkimore shkencore.

çanërisht nga aspekti i *studimeve dialektologjike, leksikologjike, onomastike, folkloriko-etnografike, historike, etj.*

Për t'ua prezentuar lexuesve metodologjinë që ka ndjekur autori gjatë hartimit të këtij fjalori dialektor për të folmen e arbëneshëve të Zarës, ne do të përpiqemi të ndjekim kronologjinë e mbarështrimit të materialit leksikor në të: Fjalori fillon me një hyrje të ngërthyer me një shtrirje shkrimore prej faqes 5—12, duke vënë në pah se Arbëneshi i Zarës që në zanafillën e themelimit të tij ishte fshat apo vendbanim i veçantë, do të thotë i ndarë nga qyteti, kurse sot ai është bërë pjesë përbërëse e qytetit të Zarës.

Lidhur me këtë koloni shqiptare të vendosur këtu në gjysmën e parë të shekullit XVIII, banorët e së cilës e heqin zanafillën e tyre nga viset buzë liqenit të Shkodrës, deri më sot janë shkruar shumë artikuj gazetarësh si dhe vështrime më të gjera shkencore, siç janë: S. Buzoliqi, F. Mikoshiqi, T. Erberi, M. Çurkoviqi, K. taljavini e shumë të tjerë, mirëpo sipas autorit të fjalorit në fjalë, këta shkencëtarë ishin mjaft të kufizuar në njohuritë e tyre për këtë të folme, kurse në disa raste patën edhe konstatime të pasakta e të gabuara.

Lidhur me ndriçimin e rrugëve të shtegtimit gjatë shpërnguljes së popullatës të kësaj oaze dialektore, autorit të këtij fjalori i dhanë dorë të fortë dy faktorë: duke qenë edhe vetë pjesëtar i kësaj kolonie shqiptare, ai ishte kureshtar të ndriçojë shkaqet dhe rrethanat nën ndikimin e të cilave u bë shpërngulja e paraardhësve të tij, nga njëra anë, dhe duke punuar gjatë viteve 1949—1951 në Arkivin Shtetëror të Zarës nga ana tjetër, autori zbuloi të dhëna të reja deri atëherë të panjohura lidhur me shpërnguljen dhe ngulimet e arbëneshëve të Zarës në vendbanimin e ri të emëruar nga vetë ata me emrin *Arbëneshi*, ndërsa nga vendësit u quajt *Arbanasi*, kurse italianët më vonë e quajtën *Borgo Erizzo*.

Lidhur me ngulimet e popullsisë së kësaj oaze dialektore në truallin e ri të Arbëneshit, autori zë ngoje tri valë shpërnguljesh:

I. *Vala e parë* e shpërnguljeve të popullsisë arbëneshë u bë në vitin 1726, e që ishte ndër shpërnguljet më të mëdha. Popullsia e kësaj turme e hiqnin zanafillën nga fshatrat Brisk, Shestan dhe nga fshati Ljare që gjendet ndërmjet liqenit të Shkodrës dhe bregdetit të Tivarit, rrëzë malit të Rumisë të trevës së Krajës, që atëbotë i përkisnin Pashallëkut të Shkodrës.

II. *Vala e dytë* ishin shpërnguljet me numër më të vogël njerëzish, që pasuan herë pas here prej vitit 1726—1733, të cilat shpesh qenë edhe shpërngulje individuale, që u vendosën, përveç në Arbënesh, edhe në vetë qytetin e Zarës, e madje edhe në fshatra të tjera të rrethinës së tij.

III. *Vala e tretë* e shpërnguljes së popullsisë arbëneshe pasoi në vitin 1733 turmë kjo e përbërë prej 28 familjesh me 199 veta. Në këtë kapitull (në hyrje) autori përmend edhe shumë toponime me interes të veçantë për studime onomastike nga njëra anë, kurse nga ana tjetër merr në shqyrtim edhe patronimet të cilat hedhin dritë në metamorfozën e gjenealogjisë antroponimike të tyre.

### E folmja e arbëneshëve — vëzhgime dialektologjike

Prej faqes 13—20 autori i fjalorit në fjalë, edhe pse deri tani nuk ishte marrë asnjëherë më parë me studime dialektologjike, i prirë nga modestia e matura, me përpikëri heton tiparet më qenësore të kësaj të folmeje, prandaj me këtë rast spikat veçoritë thelbësore të saj. Ai këtu përpiket të trajtojë edhe zhvillimin evolutiv të së folmes në shqyrtim, duke vënë njëkohësisht në spikamë edhe ndikimet e kroatishtes e të italishtes nga njëra anë, kurse nën ndikimin e faktorëve izolues dhe të një intervali të gjatë kohor të shkëputjes nga e folmja amë, nga ana tjetër kjo e folme pësoi ndryshime të mëdha, por edhe ruajti trajta arkaike, me të cilat sot banorët e *Arbëneshit* të Zarës vështirë do të merrshin vesh me banorët e emnakut të tyre *Arbëneshit të Krajës* në veçanti dhe të trevës së Krajës në përgjithësi.

Këtu më poshtë po sjellim disa nga veçoritë e kësaj të folmeje që spikat vetë autori, por po zëmë ngoje edhe disa sosh që ndeshen dhe i kemi hetuar edhe ne vetë gjatë vështrimit të fjalorit:

- Në këtë të folme, autori thekson se *h*-ja nistore nuk shqiptohet, si për shembull te fjalët: *undi* (hunda), *aje* (hae), *angër* (hangër), *ajni* (hajni), *ak-u* (hak-u), *âna* (hana), por ai nuk heton (ndoshta heton, por nuk thekson, duke pasur parasysh qëllimin e veprës) se *h*-ja nuk shqiptohet as në pozicion mestor e fundor, siç e dëshmojnë këta shembuj: *baet* (bahet), *afroet* (afrohet), *afroet shiu*, *nuk she(h) fshe(h)*, etj.
- Në ligjërimin e arbëneshëve mungon kakuminalja *rr*, prandaj në këtë ligjërim përdoret vetëm kakuminalja *r*, kështu që shpesh hasim në trajta homonimike të fjalëve me kuptime të ndryshme semantike, si: *arë* (për arrë) dhe *arë* (për tokë të punuar), *rog* (rrogë), *rotë* (rrotë), *me rua* (ruaj) dhe *me rua* (rruaj), etj.
- Në këtë të folme nuk ndeshim ë fundore, si: *pun*, *rand*, *puth*, *pushk*.
- Në vend të *a*-së ndeshim *o*: *boet*, *goti* (gati), *koli* (kali), etj.

- Njëra ndër veçoritë e kësaj të folmeje është edhe kalimi i *th*-së në *s*, siç e dëshmojnë shembujt: *me san* (them), *pris-i* (prith-i), *sonji* (thonji), *sot* (thot), kurse *dh*-ja shqiptohet si *ll*, por edhe si *t*, *d*, për shembull: *llent* (dhe-ntë), *liet* (dhiet), *erl* (erdh), *arl*, *art*, *ard* (për ardhë), etj.

Nën ndikimin e kroatishtes *ll*-ja e fortë u identifikua me *l*: *loml* në vend të *llomi* dhe *mola* në vend të *molla*, duke u rrafshuar kështu edhe tingujt *l*, *ll* dhe *dh*. Ky rrafshim dhe kalimi i *th*-së në *s* shkaktoi identifikimin e disa fjalëve me kuptime të ndryshme: *san* (thanë) me fjalën *sanë* dhe fjalët *sua* (thua) me foljen *sua me sua* (me mësua) apo *plumbi* për pëllumbi) me fjalën *plumbi* (emër metali), e *so-sa* dhe *tha*, etj. Dikur këto dalloheshin qartë, kurse sot këto janë rrafshuar, ndaj ndeshim edhe forma homonimike në shqiptim me kuptime të kundërta.

— Tingujt *ç* dhe *q* kjo e folme i rrafshoi në *ç* afrikate, që është një tipar specifik i së folmes së arbëneshëve të Zarës.

Ndërkaq, atje ku ruhet dhe shqiptohet, është shënuar edhe gjysmëzanorja *ë*.

Autori i këtij fjalori përmend edhe veçori të tjera dialektore të kësaj të folmeje, por pa pretendime e zotime të një studimi me shpjegime të hollësishme dialektologjike, por gjithnjë duke synuar që lëndën leksikore të fjalorit ta bëjë sa më të qartë e më të kuptueshme për lexuesit e studiuesit. Duke i bërë vërejtje autorëve të tjerë, ai veçon studimin e thukët e të ngjeshur, të shkruar me akribi gjuhësore të Idriz Ajetit (Istorijski razvitak gegijskog govora arbanasa kod Zadra) të botuar më 1961: „Duke u mbështetur në një literaturë të pasur albanologjike, në bazë të kërkimeve kritike të informatorëve të ndryshëm dhe konsultimin e një numri të konsideruar tekstesh të shkruara në të folmen e arbëneshëve të Zarës, Ajeti dha një vështrim definitiv të kësaj të folmeje” (f. 20).

### Shënime lidhur me kriteret e hartimit të fjalorit

Autori në këtë kapitull zë ngoje burimet e lëndës leksikore lidhur me hartimin e këtij fjalori dialektor. Siç pohon vetë autori si subjekt kryesor i shërbeu e ama e vet: „Lëndën për këtë fjalor e vola kohë pas kohe në një periudhë prej gjysmë shekulli. Fjalët dhe pjesa dërmuese e fjalive u volën nga individë të moshave të nduarnduarta — prej moshës njëzetvjeçare deri në moshën tetëdhjetëvjeçare, që i përkisnin vëllazërive dhe familjeve të ndryshme. Numrin më të madh të fjalëve i vola nga nëna ime” (f. 21). Meqë e ëma e autorit qysh si vajzë, një kohë të gjatë kishte jetuar me gjyshen e vet të lindur në vitin 1820, do të thotë ende pa u mbushur njëqind vjet nga shpërngulja e arbëneshve në truallin

e ri, e cila ende kishte ruajtur dhe kishte konservuar një fond të pasur fjalësh shqipe të bartura nga e folmja e truallit të lashtë. Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve në komunikimin e përditshëm të folësve të të folmes së diasporës të Arbëneshit të Zarës nuk përdoret më, sepse ato janë harruar e janë shlyer nga kujtesa kolektive. Prandaj vetë ky fakt dëshmon se kjo e folme është rruddhur, është ngushtuar dhe është varfëruar nga aspekti sasior i fondit leksikor dhe me kalimin e kohës ajo gjithnjë e humb funksionin dhe tendencën e zgjerimit e të pasurimit të leksikut të saj. Pikërisht për këtë qëllim autori nëpërmjet folësve të moshuar e nëpërmjet gojës së të amës së vet u përpoq që ta shpëtojë pjesën dërmuese të pasurisë leksikore të kësaj të folmeje, duke e regjistruar e duke e ruajtur së paku të shkruar e të konservuar si thesar të rëndësishëm të fondit leksikor të kësaj oaze të izoluar gjuhësore, që përdor sot apo që ka përdorur dikur në komunikimin e vet të përditshëm.

Ndërkaq, prej faqes 23—134 autori ka mbarështruar sipas rendit alfabetik lëndën leksikore të vjelë me vite të tëra, pothuaj tërë jetën e vet nga e folmja e arbëneshëve të Zarës, nga e folmja e vendlindjes së vet.

Autori nuk voli lëndë leksikore nga tekstet e shkruara të shkrimtarëve arbëneshë të Josip Reles, Shime Deshpalit e nga Miroa i Kikicës (Budimir Peroviçit), duke konsideruar se ata në veprat e tyre përdorën fjalë edhe nga gjuha letrare e njësuar, fjalë këto që ishin të injoruar nga folësit e arbëneshëve të Zarës.

Kështu, autori duke pasur parasysh qëllimin dhe synimin drejt realizimit të hartimit të një fjalori dialektor të kësaj të folmeje, ai u përqendrua kryekëput në lëndën leksikore të vjelë nga informatorët, të cilët nuk kishin pasur kontakt me gjuhën letrare shqipe, madje as me shqipen e periudhës së Austrohungarisë, që përdorej aso kohe në shkollat shqipe nga instruktorët shqiptarë të dërguar në këtë koloni. Pra, edhe kjo e dhënë dëshmon për një kriter të rreptë të këtij fjalori kryesisht me një fond leksikor të së folmes autentike të arbëneshëve, duke ia shtuar vlerën këtij fjalori me karakter dialektor. Edhe pse kanë kaptuar më se dy shekuj e gjysmë të izolimit dhe të shkëputjes nga e folmja amë, megjithatë, fjalori sjell një mori variantesh sinonimike, që dëshmojnë për një pasuri relative të kësaj të folmeje.

Një pjesë të mirë të fjalëve nga kjo e folme si njësi leksikore, autori i konkretizon dhe i kuptimëson në kontekste fjalish, duke i konstruktuar vetë këto fjali siç pohon ai, apo edhe duke i mbajtur në mend që nga fëmijëria ose duke i dëgjuar edhe nga e folmja e përditshme në gjendjen e saj të sotme. Në këtë drejtim ai shfrytëzoi edhe fjalorët dhe përmbajtjet e autorëve të tjerë para një shekulli më parë e këndeje, duke filluar nga F. Mikloshiçi e K. Taljavini, të cilat nga aspekti fonetik ishin të paqarta e me „defekte”, por që autori i fjalorit në fjalë i korrigjoi

dhe i plotësoi në mënyrë të denjë, duke përpiluar në këtë mënyrë fjalorin me rreth 5000 njësi leksikore dhe me një numër të konsideruar thëniesh e shprehjesh nga kjo e folme.

Emrat, si njësi leksikore e gramatikore i shënoi në trajtën e pashquar dhe në të shquarën, në numrin njëjës dhe në numrin shumës, duke iu përmbajtur temës së emrit. Ndërsa mbaresat shquese i shënoi në kllapa, kurse te foljet parafjalën *me* ose *m'u* grimca të përemrit vetor me të cilat shprehet diateza pësore e foljeve gjithashtu i shënoi në kllapa. Ai shënoi besnikërisht edhe theksat në theksimin e rrokjeve, veçanërisht i kushtoi kujdes shënimit të theksit hundor, duke dëshmuar kështu se kjo e folme e ka ruajtur besnikërisht nazalitetin që nga e fomja e lashtë e së folmes amë: *shî, shîna, rakî, m'u rî, robî*, etj., që i ndeshim edhe sot në të folmet e Malësisë së Madhe (Hot, Grudë e Triesh) dhe në Krajë. Mirëpo nuk e pa të arsyeshme të shënojë edhe gjatësinë e zanoreve. Në fjalor ndeshim një numër të konsideruar fjalësh me origjinë sllave, kryesisht kroate dhe romane, që depërtuan nëpërmjetj italishtes. Duke bërë krahasime ndërmjet të folmes së arbëneshëve të Zarës dhe të folmes së Krajës, autori nxjerr përfundim se pjesën më të madhe të këtij fondi leksikor, arbëneshët i morën pas vendosjes në truallin e ri, kurse një numër të vogël fjalësh të huaja, veçanërisht ato turke i bartën nga e folmja e truallit të tyre të lashtë.

Vlen të vihet në spikamë se pjesa dërmuese e romanizmave, kryesisht nga fusha e fjalëformimit me prejardhje veneciane apo dalmatino-italiane, hynë me rrugë të tërthortë nga të folmet kroate të rrethinës së Zarës, huazime këto që folësit e këtyre të folmeve i kishin pranuar nga italishtja. Prandaj numri i kroatizmave dhe i italianizmave të kroatizuara në këtë fjalor është kufizuar nga ana e autorit aq sa ka qenë e mundur, duke e ngushtuar në një fond leksikor që gjëllin në këtë të folme deri në kohën e okupacionit italian. Këto italianizma, në këtë të folme, shpeshherë nxorën nga përdorimi fjalët autoktone shqipe, kurse një numër sosh, duke u përdorur gjithnjë e më rrallë, u pasivizuan. Autori shënoi edhe disa fjalë që kishte dëgjuar në këtë të folme, por që nuk kishte arritur t'i deshifrojë semantikisht, prandaj ato i shënoi me pikëpyetje, si: *kushrî(-a)* e identifikoi me *susjedstvo* (fqinjësi), duke mos ditur kuptimin e saj të drejtë: *kusherinj-t*, lidhje farefisnore, lidhjej gjaku, djem të dy vëllezërve (kusherinj të parë), kusherinj të dytë (që kanë gjyshërit vëllezër), etj., do të thotë degëzim horizontal i një vëllazërie të caktuar; *pÿkën(-knja)* e shpjegon me *pikël?* dhe *klin* (kunj)? duke mos qenë i sigurt se pyka është një copë druri apo metali e ngushtë dhe e mprehtë nga njëra anë që shërben për të çarë më lehtë dru, gurë etj., deri diku e ngjashme me kunjin, por që nuk ka formë të rrumbullakët si kunji, por ka trajtë të mprehtë e petake.

Ndërkaq, fjalën *rânz(-a)*, ž. *arâjza?* (f. 103) e lë pa shpjegim, ku sigurisht është fjala për *rrëzë*, që përdoret së bashku me një emër në rasën rrjedhore për të treguar vendin në pjesën e fundit të një sendi ku ndodhet dikush a diçka ose ku bëhet një veprim; *rrëzë mali* (kodre) *rrëzë muri* (FGJSSH, f. 1701).

*Sllavizma* ndeshim më së tepërmi në këtë fjalor, siç e dëshmojnë fjalët: (*i, e*) *bogát*, *me çestitát*, *çir-i*, *dllan-i*, *febrari*, *me gazit* (shkel), *maçi-a* (njerka), *me morat*, *me otrovat*, *me plivat*, *me postit*, *me ravnu* (rrafshoj), *me shçez*, *uzdaj-a*, *voj* (vola): *nuk kam voj me këndua*, *me solit* (*i qes* apo *i shti kripë*), etj.

*Romanizmat* gjithashtu janë të shpeshta si: *agúsht* (*úshti*) për muajin gusht, *akvidot-i* (ujësjellësi, Akvidoti i plak top.), *amos* (*ori*): *me bo amor* (dashuroj), *bona* (e dashura ime), *diretúr-i* (drejtor), *dotúr-i* (doktor, mjek) *me fumát* (pi duhan), *me paktua* nga *pakto-are* (pajtoj), *m'u pezua* (peshoj), *i, e, surdët* (*i shurdhët*, nga lat. *surdus*). etj.

*Turcizmat*. — është interesant se në këtë të folme janë ruajtur kaq gjatë, që nga shpërngulja kur kjo e folme kishte kontakt me turqishten edhe turcizmat, si: *aferim* (të lumtë) *aku* (haku), *i, e begenishim* (*i dashur*), *belçi* (ndoshta), që përdoret edhe sot mjaft dendur në të folmen e Krajës e të Ulqinit, *dÿbje* (shybe, dyshim), *gjilep-i* (tufa), *pandur-i* (xhandar), *tabut-i* (mjete për të bartur të vdekurin), *taman*, *tavë*, *tavan*, *vakt-i* etj.

*Fjalëformimi* me ndikim të huaj. — ndikimet e huaja kanë prekur edhe në fjalëformim, veçanërisht nga ndikimi i sllavizmeve ndeshim fjalëformime të kësaj natyre: *me citát* (thith, nga *sisati*), *me uthulua* (zakiseliti), *me turjelue* (nga *svrdlati*), *m'u trashue* (odebljati), *përmidor-a* (kroat. *nadlanica*), e ndonjë tjetër.

*Fjalëformimi i brendshëm* i kësaj të folmeje është zhvilluar në mënyrë të pavarur nga ndikimet e jashtme apo nga ndikimet e të folmeve të tjera dialektore të shqipës dhe të gjuhës letrare të njësuar, me të cilat ajo nuk pati kontakte gjatë zhvillimit evolutiv të saj, sepse u gjend në pozitë të izoluar të një ishulli gjuhësor i shkëputur nga trualli i përpam, që kishte vazhdimësi tokësore me të folmet tjera dialektore.

Është me interes të veçantë të spikaten disa formime foljore nga emrat, si: *me capua* (prashit) nga emri *capûni*, *me baltinua* (lyerje me baltë) *me fashatë* (lidh, nga *fashë-a*), *me frakaleshue* (shapulloj, nga *flakaresh* me formë metatetike *frakalesh*), *me fajua* (nga *faj*, *fajësua*), *e ka fundua shpin e vet* (nga *fund-i*, *e ka shkatërruar*), *me gurua* (muroj me gurë), *me kashtua* (shtroj me kashtë), *me perdua* (ndaj me mur), *me peshkât* (peshkoj), *me zvirgjinua* (ia marr virgjinitetin) *me tënd* (shtrëngo) *m'u vranua* (vrenjtem), *me përçep* (qep), *m'u përndjers* (djersitem), *me spermend* (përkujtoj), *me trapua lendinën* (prashit thellë, çel tokë të re), *me thurua* (thur) *me ujzua* (rrjedh), *me kaptua* (kalloj), etj.

Neshim edhe disa fjalëformime ndajfoljesh kohore, si: *masmot* (partjetrivjet), *masmez dita* (pasdita), *tamasnesër* (tejpasnesër), *tapardje* (e katërta ditë prapa), *taparvjejt* (i katërti vit prapa), *tamot* (viti i dytë i ardhshëm), etj.

Një numër fjalësh, të cilat sipas mendimit tim i përkasin leksikut origjinal të gurrës shqipe, do të ishin me interes të veçantë që të aktivizohen në mbarë shqipen letrare, siç janë për shembull fjalët e shprehjet: *fundaç-i* (llumi, telfja e kafesë, *kanxhel-i* (pjesa e vargoit në formë të shkronjës S ku varen kusiat), *kaptim-i* (perëndim-i, emër i prejardhur nga folja kaptoj) në *kaptim të diellit* (në perëndim të diellit), *karabush-i* (misër), *karbû-ni* (thëngij), *lidhc-i* (për liktyrën), *liskûr-a* (lëvore lisi), *lugicë* (lugë e vogël), *muriç-i* (mur i vogël), *pick* (majë), në *pick të pickut* (në skaj të skajit apo në fund të fundit), *rethoj-i* (oborri), *capûn-i* (terrakop), *ujzi-a* (lagështia): *ujzia 'sht kap murit; broncini po të ujzon* (tasi po të rrjedh), etj.

Në fushën e fjalëformimit tërheq vëmendjen edhe aspekti diakronik i etimologjisë së disa fjalëve, si: *tëlçem-i* (tlyen-i, gjalp-i), që është formë e aglutinuar e nyjës së përparme të dhe foljes *lyej* dhe mbaresës të pjesores së zgjeruar *-m* e mbaresës shquese *i* pra nga:  $të + lye + m = tëlçem-i$  (khs. *me tpan-i* nga të + pamë), vizitën që e bëjnë gratë dy herë në vit në gjini të tyre): *i fërgonj vôt me tëlçem*. Këtë trajtë e ndeshim edhe sot ndër të folme të Malit të Zi *t'çyem me çye*, çyej (me ngjye, ngjyej) me kuptimin *shllî-a*, *lëng-u* (lëng djathi) dhe *t'ngjyem* (ana e Vuçiternës), *m'u strunjât*, nënshtroj diçka ose tërheq me forcë (khs. shtrungë-a fjalë me përhapje të madhe ndër popujt ballkanikë e me burim të diskutuar, por që sipas të gjitha gjasave lidhet me fjalën shqipe *shtrëngo*, E. Çabej, *Studime gjuhësore II* Prishtinë, 1976, 157). Në këtë fjalor ndeshim më rrallë në formime kompozitore, si: *bishkuç-i*, *bregdeti*, *buthmbrâpa*, *çinkamb-a*, *pulibardh-i*, *pupugjel-i*, *lulkuq-i*, *shtrembabuza* (grua gojështrembër). Si duket nën ndikimin e kroatishtes emrat kompozitorë *çinkamb-a* (nga stonoga) është përdorur në gjininë femërore, kurse në letrariste e ndeshim në gjininë mashkullore *qindkëmbëshi* dhe *pulibardh-i* (nga galeb-i) në gjininë mashkullore, në vend të gjinisë femërore *pulëbardhë-a*.

Në fjalorin dialektor të dr. Kruno Kërstiqit ndeshim një numër të konsideruar fjalës të metatetizuara, që dëshmon se në të folmen e arbëneshëve të Zarës: metateza është dukuri specifike: *frutula* (flutura), *frakalesh* (flakaresh), *gravan* (gavran), *namastir* (manastir), *me topcua* (me coptua), *i thkjell* (i kthill), *m'u thkye* (m'u kthye), *i thkyem* (i kthyem), që e ndeshim edhe ndër të folme të Maqedonisë Perëndimore, Dibër, Gostivar, Kërçovë etj., *çakafyt*, *ërfeja* (rrufeja), *ërfim* (rrëfim), etj.

Në këtë fjalor do veçuar formimin e shumësit të emrave me prapashtesën *-nje* për të cilin tip flet edhe Çabej (në *Studime gju-*

*hësore III*, Prishtinë, 1976, 259, si *gardhnje, rushnje*, që i sjell nga e folmja e Arbëneshit të Dalmacisë). Madje në këtë të folme kjo është formë e rregullt për të cilën dëshmojnë shembujt që po shënojmë më posht: *djath-djathnje, drapën-drapnje, dreç-dreçnje, dhe-dhenje, gjel-gjelnje, katund, katundje*, por edhe *katungje* analog me *cung-cungje; kopësht-kopështnje, mut-mutnje, pllumb-pllumnje, prith-prithnje, pus-pusnje, riçën-riçnje, shtrat-shtretnje, shkop-shkopnje, shpirt-shpirtnje, undi-undnje, vend-vendnje, vor-vornje, vot-i-votnje* (votat e votimit). Me këtë prapashtesë është formuar edhe emri i fshatit *Kështenjë* në Krajë dhe emra vendesh të pasur me gështenja, arrë, frashën; *koshnjet, arrnjet, frashnjet* shkozet, Qerret, kurse *dushk-dushnje* etj. e sot mund të ndeshen edhe si emra vendbanimesh, siç e dëshmon sot toponimi *N'Ddushnje t'Lekiqit*, që e ndeshim në fshatin Stubëll e Poshtme të Karadakut.

Ndërkaq disa emra shumësin e formojnë me anë të metafonisë, si për shembull: *sjap-sjep, rath-i=rethët; thas-i=thesët*, etj. (Ata 'sht thasi me tri çoshe) Format e emrave *rath-i* dhe *thas-i*, që në këtë të folme përdoren për numrin njëjës, ndërsa trajtat *reth* dhe *thes* për numrin shumësin, dëshmojnë për një relik të kryehershëm të shqipes si gjuhë indoevropiane. Sipas gjuhëtarëve: Kamardës, Meyerit, Vajgandit, Bariqit dhe E. Çabejt bazë e emrit të shqipes merret forma\* *rath*, trajtë që ruhet te shumësi *rrathë*. Prandaj lidhur me këta dy emra kemi këtë skemë *rrath-rrathë* dhe *thas-thes*. Pra, te *rrathë* e te *thes* do parë forma e singularizuar e shumësit, kurse te *rrathë* e *thasë* forma e pluralizuar e njëjësit. Prandaj te këta emra *rath-rethët* dhe *thas-thesët* që sot i ndeshim në të folmen e Arbëneshit të Zarës, te të folmet e mbarë shqipes, pra edhe në letrarishite sot ndeshim raportin e dikurshëm skematik të përmbysur *rrath-rrathë* dhe *thes-thasë* që përdoren si shumësin të singularizuar. Çabej thekson se këtë tipar me sy të mprehtë e kishte vërejtur Henrik Bariçi, duke e dëshmuar me të dhënat gjuhësore të së folmes dialektore të Arbëneshit të Zarës, ku kishte ndeshur *rath* dhe *thas* për njëjës dhe *rethë* dhe *thesë* për shumësin (E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1976, 329) ashtu siç i shënon në fjalorin e vet edhe sot dr. Kruno Kërstiçi. Shumë albanologë të tjerë iu sollën rrotull kësaj çështjeje. Kështu njëri ndër ta ishte edhe Schmid, i cili te shumësi i *thasë* shihte një *neutrum pluralis*, ku *a-ja* e të cilit dha *ë*, kurse te *thes* më tepër e pandehte një kolektiv *\*saqom* sesa *\*saqes*. Ndërsa po të marrin parasysh dëshmitë e autorëve të vjetër te Buzuku ndeshim *thes* për njëjës, kurse *thasë* për shumësin. Këto trajta i ndeshim edhe te Pjetër Budi, Frang Bardhi e te Pjetër Bogdani si dhe ndër kolonitë shqiptare të Greqisë ndeshim *rrath=rrathë* dhe *thes=thasë*, q ëdëshmon se kjo skemë është mjaft e moçme në gjuhën shqipe. Prandaj trajtat që i ndeshim sot në të folmen e ishullit gjuhësor të Arbëneshit të Zarës *thas* për njëjës dhe *thesë*

për shumës dhe *rath*=*rethë*, dëshmojnë se janë mjaft të vjetra e paraletrare.

Në këtë fjalor shumësin e singularizuar e ndeshim edhe te emri *tërç-ët*, që në këtë të folme përdoret në kuptimin e brekëve, duke e humbur kuptimin e tij primar për *tirç-i*, që e ndeshim të përdoret ndër të folme të tjera dialektore të shqipes, pastaj emri *trût*, *vjelunat* (të vjelunat) si dhe në disa toponime si: *Trikalat*, *Tridera-t*.

Edhe në këtë të folme emrat farefisnorë i ndeshim të përdoren me një të përparme: *i ati*, *e ama*, *i biri*, *e bija*, *i soçi*, *e soçea*, etj., ashtu si në mbarë të folmet e shqipes.

Në këtë fjalor, përveç materialit të pasur leksikor të kësaj të folmeje dialektore, autori sjell një numër të konsideruar toponimesh nga ky lokalitet, të cilët janë me interes për studime onomastike, si: *Trikala-t*, *Tridera-t*, *Vani i Kishës*, *Vani i Brodanit*, *Vani i Joviçit*, *Vani i bregdetit*, *Akvidoti i plak*, etj.

Prandaj duke i pasur parasysh këto vlera të shumëfishta shkencore të veprës në fjalë mund të pohojmë se FJALORI I SË FOLMES TË ARBËNESHËVE TË ZARËS hartuar nga Dr. Kruno Kërstiçi, paraqet një kontribut të rëndësishëm në pasurimin e leksikografisë shqiptare në veçanti dhe zgjeron njohuritë dialektologjike të kësaj oaze dialektore në përgjithësi.

ky numër imponant mund të marrim me mend se sa e sa më tepër diskutime dhe materiale do të jenë mbajtur dhe do t'i ketë pasur në disponim ky Kuvend se që janë botuar.

Kuvendi është konvokuar me iniciativën e papës Klementit XI, me origjinë shqiptare që kishte prirje dhe dëshirë të flaktë për zgjidhjen e problemeve në botën shqiptare. Në fakt, ky moment ka ndikuar më së tepërmi dhe ka qenë vendimtar për mbajtjen dhe për suksesin e madh të Kuvendit të Arbënit. Me plotë arsye mund të mendohet se përveç kësaj ndërmarrjeje të rëndësishme meritë e këtij pape është edhe themelimi i Seminarit Arbëresh në Palermo nga Gjergj Guxeta dhe hapja e katedrës së gjuhës shqipe në Romë, kështu që Kuvendi i Arbënit ishte vetëm një prej aktiviteteve të shumta të tij për çështjen shqiptare. Prandaj, konvokimi i Kuvendit në Mërqi është në lidhje të drejtpërdrejtë me çështjet shqiptare nga aspekti eklizistik okcidental në kohën kur populli shqiptar po shkombëtarizohej në mënyrë masive, duke u dergjur nën sundimin shekuflor të armiqve aziatikë.

Përcaktimi i Papës që këtë Kuvend të klerit shqiptar ta udhëheqë argjipeskvi i Tivarit Visk Zmajeviçi, „personalitet më i shquar i popullit kroat në shek. 18 dhe politikani më i rëndësishëm kishtar i kohës së tij në Ballkan”, kishte rëndësi të dorës së parë për suksesin sa më të madh të këtij Kuvendi jo vetëm në jetën e shqiptarëve, por edhe më gjerë. Pra me emrin e tij lidhet jo vetëm organizimi, mbajtja dhe hartimi i teksteve të Kuvendit, por edhe zbatimimi i dekreteve të tij.

Përveç miqësisë së ngushtë me papën Klementin XI, të organizimit dhe të udhëheqjes së suksesshme të Kuvendit të Arbënit, V. Zmajeviçi u mor me çështje shqiptare deri në ditët e fundit të jetës së tij. Ai madje qysh në vitin 1726 mori lejen për vendosjen e shqiptarëve të ikur nga turqit në Arbëneshi (Arbānasi) afër Zarës dhe tregoi interesim të vazhdueshëm për ta, kështu edhe në momentin e fundit, para vdekjes, me testament të veçantë la të gjithë pa-

surinë e tij për shkollimin e kuadrit shqiptar pranë Kongregacionit në Romë. Këto janë vetëm disa momente që e bëjnë këtë fytyrë (dhe gjithë familjen e tij nga Perasti afër Kotorit) të ndritshme dhe të dashur në historinë e popullit shqiptar. Kësodore kuptojmë se veprimtaria e tij shumëdimensionale reflektohej në jetën kishtarë dhe politike në këto treva të okupuara. Në mënyrë të veçantë dhe në një formë normative V. Zmajeviçi i kishte dhënë impuls kësaj veprimtarie si autor i tekstit të Kuvendit, të hartuar nga dora e tij në gjuhën latine dhe të botuar tri vjet pas mbajtjes së Kuvendit (1706). Tash për tash nuk dihet saktësisht a thua ishte ai edhe autor i përkthimit të këtyre teksteve. Këtë moment të rëndësishëm nuk ka arritur ta konstatojë as R. Ismajli, sikundër edhe as shumë çështje të tjera përkitazi me përkthimin e materialeve të Kuvendit të Arbënit. Sidoqoftë, fytyra e ndritshme e V. Zmajeviçit meriton të studiohet dhe të ndriçohet nga aspekte të shumta, kështu që bashkë me papën Klementin XI — Albani paraqesin tema të veçanta dhe me interes të shtuar edhe në mjedisin tonë kulturor.

### Qëllimet dhe rëndësia e Kuvendit

Kuvendi i Arbënit, sikundër edhe ai i Matit (1462), të cilin e kishte konvokuar Skënderbeu dhe e kishte udhëhequr Pal Engjëlli, argjipeskvi i Durrësit, kishte për qëllim organizimin sa më të mirë të jetës dhe të veprimtarisë ekleziastiko-politike kundër turqve. Nga të gjitha materialet e këtij Kuvendi, që janë, grosso modo, tri shkresat e V. Zmajeviçit dhe dekretet apo aktet normative — kuptojmë angazhimin e krerëve shqiptarë kundër asimilimit dhe shkombëtarizimit të popullsisë shqiptare. Ndonëse në shikimin e parë duket se kërkesat themelore të organizatorit ishin të drejtuara vetëm për mbajtjen e rendit kishtar, duhet thënë se, siç konstaton R. Ismajli, „barabar me to radhiten edhe kër-